

Pritja e imam Mehdiut dhe karakteristikat e shtetit të tij

Haxhi Vullnet Merja

Me emrin e Allahut të Gjithmëshirshmit, Mëshirplotit.

Falenderimet më të sinqerta i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi profetin Muhamed dhe mbi familjen e tij të pastër e të bekuar.

Përshëndetje mbi pritësit e Mehdiut. Përshëndetje mbi ata që pritja e tyre është gërshtuar me gëzim dhe nga ajo është krijuar një dashuri e shenjtë.

Përshëndetje për ata persona që sytë i kanë ngulitur në horizonte të largëta, që me ardhjen e tij të zbukurohet e të hijeshohet gjithësia. Përshëndetje për Mehdiun e premtuar, argumentin e fshehur, i cili, ai vetë është në pritje që t'i ndihmojë të privuarit dhe të shtypurit. Qëndrojmë duke e pritur atë që të vijë dhe me ardhjen e tij të na heqë pikëllimin dhe të vendosë drejtësinë e paqen anembanë botës.

I nderuar drejtor i shoqatës së “Kur’anit”, profesor Muhamed Bakir Salihi, të nderuar klerikë, intelektualë, studiues. Të nderuar motra dhe vëllezër besimtarë

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Allahu i Madhëruar në Kur’anin fisnik thotë:

{وَأُرِيدُ أَنْ نَمُنَّ عَلَى الَّذِينَ اسْتُضِعُوا فِي الْأَرْضِ وَنَجْعَلَهُمْ أَئِمَّةً وَنَجْعَلَهُمُ الْوَارِثِينَ} {القصص: 5}..

“E vullneti Ynë ishte që t’u japim mirësi atyre që qenë të shtypur në tokë t’i bëjmë prijës e t’i bëjmë trashëgimtarë.” (Sure Kasas, ajti 5)

وقال تعالى { وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ مِنْ بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا يَعْبُدُونَنِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا } {النور: 55}.

Po ashtu thotë: **“Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t’ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë...”** (Sure Nur, ajeti 55)

Me kalimin e kohëve, kultura dhe civilizimi i njerëzve zhvillohen dhe përparojnë. Sa herë që njeriu hyn në një periudhë të re të historisë, mendon se ka arritur në një shkallë që mund t’i zgjidhë të gjitha problemet e jetës. Edhe pse mendon në këtë mënyrë, përsëri ai përballet me probleme krejtësisht të reja. Në një gjendje të tillë, njeriu e kupton se për të dalë nga kjo huti dhe

errësirë dhe për të arritur një jetë të qetë e të kënaqshme, atij i nevojitet një shpëtimtar, i cili ka si qëllim kryesor shpëtimin e njeriut nga devijimi dhe shkatërrimi.

Në ditët e sotme as civilizimi, as përparimi e as integrimi nuk kanë arritur t'ia lehtësojnë dhimbjet njeriut qoftë edhe një përqindje të vogël.

Po ashtu, as “elektronika gjigande” e cila ka arritur të zgjidhë miliona problema matematikore, nuk ka arritur të zgjidhë problemet e njeriut që shtohen dita ditës.

Vërtet, koha ka përparuar nga ana materiale siç janë arritja në hënë, ndarja e qelizës..., etj, por asgjë nuk ka arritur të përparojë në botën e njeriut me përjashtim të një sasive sa është përmasa e gishtit të dorës kur është e mbyllur.

Shkenca e sotme arriti ta dërgojë njeriun në hënë, por nuk ka arritur ta dërgojë njeriun në të vërtetën e tij, ta njohë atë me vetveten dhe me Krijuesin e tij!

Edhe pse janë shkruar mjaft për njeriun por asgjë nuk është e shtuar për njohjen e plotë të tij.

E vërteta e hidhur në botën aktuale është përhapja e shtypjes, agresionit, padrejtësisë, imoralitetit e të tjera fenomene negative dhe shkatërruese. Sot jetojmë në një botë, ku individët që sundojnë e udhëheqin mendojnë dhe jetojnë vetëm për vetat e tyre. Marrëdhëniet e tyre me të tjerët janë të bazuara në nevojat dhe interesat personale dhe miqësia e tyre varet vetëm nga përfitimet që do të korrrin. Në shumë shoqëri të botës mbizotëron pasiguria e destabiliteti dhe dinjiteti i njeriut injorohet dhe nëpërkëmbet në rrjedhën e jetës materialiste.

Jetojmë në një periudhë ku paqja, siguria dhe qetësia e vërtetë janë fenomene që kanë humbur dhe janë bërë të padukshme. Drejtësia dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut janë fjalë të bukura që dëgjohen prej disa njerëzve, të cilët prezantohen si përfaqësuesit e njerëzimit. Në këtë krizë të pafund, gjëja e vetme që ndriçon zemrat e njerëzve është premtimi i Allahut që jep shpresë për lirim dhe shpëtimin e njerëzimit. Në ajetin e lartpërmendur Allahu i Madhëruar në Librin e Tij, Kur'anin fisnik thotë se do të vijë një ditë që këtë tokë do ta trashëgojnë ata të cilëve u është bërë padrejtësi dhe atë ditë do të mbizotërojë një sistem tjetër dhe e tërë bota do të marrë një ngjyrë tjetër. Ajo ditë është dita e ardhjes së shpëtimtarit, Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Ai do të dalë nga retë e errëta të kohës dhe do të shkëlqejë si dielli. Ai do të vijë që t'i zbulojë sekretet e fshehta të historisë në gjokset plot dhimbje dhe njeriut do t'ia kthejë historinë krenare dhe kuptimplote.

Ai është Mehdiu i premtuar, shpëtuesi i njerëzimit në tokë. Në kohën e ardhjes së tij do të shkatërrohen fuqitë e injorancës. Të gjithë do të jetojnë bashkarisht në vëllazëri nën sundimin e tij të drejtë dhe mbi këtë tokë do të sundojnë të drejtët dhe të devotshmit. Atë ditë, ndriçohen zemrat e njerëzve. Imam Mehdiu do të përhapë ndjenjën e humanizmit dhe marrëdhëniet shoqërore në kohë e tij do të jenë të bazuara në dashuri dhe miqësi. Sa e bukur do të jetë bota kur

do të pastrohen shpifjet, dhuna dhe padrejtësitë, dhe pushteti i drejtë dhe i vërtetë do të zgjerohen anembanë globit!

Të nderuar të pranishëm: Shumë herë dëgjojmë fjalën “Pritje”.

Vallë, ç`farë kuptimi ka fjala “Pritje”?

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: **“Më e përsosura e punëve të ymetit tim është pritja”**. Sa i mrekullueshëm ky hadith! Ai përmend punët dhe jo ngurtësimin, përtacinë apo dembelizmin. Në këtë mënyrë ky hadith na e sqaron se pritja është punë dhe veprimtari.

Pritje do të thotë refuzim i plotë i të gjitha ngjyrave të padrejtësisë që gjinden në rruzullin tokësor. Cilido që është në pritje të imam Mehdiut duhet t'i kundërshtojë të gjitha ngjyrat e padrejtësisë dhe të zbatojë thënien e Allahut i cili në suren Hud, ajeti 113 thotë:

وَلَا تُرْكُوا إِلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا فَتَمَسَّكُمُ النَّارُ...

“Dhe mos anoni nga ata që bëjnë padrejtësi, përndryshe do t'ju kapë edhe juve Zjarri...”

Besimi në pritjen e imam Mehdiut nuk do të thotë shpërdorim kohe dhe grumbullim pasurish. Por, ai besim është burim force dhe lëvizjeje, me qëllim që të kundërshtohen të gjitha padrejtësitë dhe shkatarrimet e përhapura në rruzullin tokësor dhe të sakrifkohet për pastrimin e tokës prej atyre padrejtësive dhe fenomeneve të shumta negative.

Fjala pritje nuk do të thotë që të rrimë në heshtje, përderisa Allahu do të sjellë imamin për të pastruar tokën prej padrejtësive, por duhet të përpiqemi me të gjitha mundësitë tona që ta përgatisim atë moment të shumëpritur.

Duhet që të zbatojmë përgjegjësitë tona ndaj vetes, ndaj familjes dhe ndaj shoqërisë ku jetojmë, me qëllim që si vetat tona, familjet tona dhe shoqërinë ku jetojmë ta udhëheqë drejtësia dhe moralit e përsosura.

Mirëpo të pakët janë ata që janë të njohur me të vërtetën e fjalës “pritje”. Bindja që një ditë do të vijë shpëtimtari i kësaj bote, pritjes tonë i jep një kuptim dhe dimension më të gjërë. Në realitet, pritja nënkupton edhe përpjekjen e njeriut për tu ngritur më lart në shkallët e përsosurisë dhe për të arritur në një përfundim më të mirë nga gjendja aktuale. E kjo çështje është gjëja më e vlefshme për njeriun. Ajetullah Khamenei, Lideri Suprem i RII në lidhje me dimensionet e pritjes thotë: “Një dimension i pritjes është të mos jesh i kënaqur me gjendjen aktuale. ‘Presim’ do të thotë se çdo të mirë që kemi vepruar është e pakët dhe presim që bota të mbushet me mirësi.”

Një dimension tjetër i pritjes është shpresa dhe optimizmi i besimtarëve për të ardhmen e tyre. Këtë shpresë atyre ua forcon edhe më shumë ajeti 55 i sures Nur që thotë:

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ مِنْ بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا يَعْبُدُونَنِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا وَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ (٥٥)

“Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t’ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë...”

Pritja e besimtarit ka kuptimin se do të vijë ajo ditë që drejtësia do të mbulojë tërë botën. Shpirti i pritjes, njeriut i mëson të luftojë në rrugën e drejtësisë dhe të së vërtetës”.

Pritja e imam Mehdiut është komentuar në dy lloje:

1- Pritja negative shkatërruese

2- Pritja pozitive ndërtuese

Pritja negative përfaqësohet nga qëndrimi i cekët për ardhjen e Imam Mehdiut. Disa persona sipërfaqësor janë të mendimit se duhet të presim që kjo botë të mbushet me të këqija derisa drejtësia dhe e vërteta të mos kenë përkrahës, kështu që në këtë mënyrë shpejtohet shfaqja e Shpëtuesit, i cili do të vendosë paqen dhe drejtësinë. Sipas përkrahësve të këtij qëndrimi, nuk duhet bërë asnjë lloj përpjekjeje për largimin e dhunës nga sipërfaqja e tokës. Kjo lloj pritjeje është negative, sepse e vret shpirtin e lëvizjes e të sacrifices te njeriu dhe e bën atë që të heqë dorë nga çdo lloj lëvizje pozitive. Ky lloj qëndrimi është i gabuar në lidhje me pritjen dhe me vete sjell pasoja të ndryshme si neglizhencën dhe dekadencën në shoqëri, të cilat asnjëra nuk përkon me mësimet e larta e të pastërta islame.

Pritja pozitive dhe frytdhënëse është ajo në të cilën individi është përgjegjës për veten për familjen dhe për shoqërinë. Kjo pritje, është një lloj angazhimi dhe motor lëvizës, madje llogaritet edhe si një adhurim. Pritja pozitive bazohet edhe në ajetet e Kur’anit dhe transmetimet islame. Ajetet e Kur’anit, ardhjen e Mehdiut a.s. e paraqesin si zinxhirin e fundit të luftës mes të mirës dhe së keqes, dhe dëshmon se në fund e mira do të triumfojë. Kështu që, pritja tek besimtarët krijon një shpresë dhe vullnet për të vepruar punë të mira. Allahu i Madhëruar në Kur’anin Famëlartë, në ajetin 5 të sures Kasas thotë: “E Ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues”.

Përkrahësit e pritjes pozitive janë të bindur se gjatë historisë kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë dy grupe, njëri i mirë dhe njëri i keq, të cilët vazhdimisht do të përballen me njëri-tjetrin dhe do të vijë koha që fitorja do të jetë në anën e të mirëve dhe atyre që punojnë për ngritjen e vlerave shpirtërore.

Karakteristika e pritjes pozitive të besimtarit është se ia forcon mardhëniet më shumë me Shpëtimtarin e kësaj bote. Njerëzit nga dhimbjet dhe pozitat e tyre të papërshtatshme ankohen dhe kërkojnë shpejtimin e ardhjes së tij. Kjo pritje ka vlerë jashtëzakonisht të madhe. Përderisa njeriu krijon marrëdhënie me vlera hyjnore, ai gjithashtu vazhdimisht dëshiron që të ngjitet në shkallë më të larta të përsosmërisë. Është e natyrshme se lidhja me individin që pasqyron fuqinë dhe drejtësinë hyjnore, te njeriu krijon një forcë zhvillimi dhe bëhet shkak i progresit të tij. Por duhet patur parasysh se një lidhje e tillë duhet të jetë serioze dhe e devotshme.

Me ardhjen e Imam Mehdiut (a.s.) do të zhduken retë e zeza të paditurisë dhe drita e dijes do të rrezatojë në mesin e njerëzve. Burimet e dijes do të vlojnë dhe do të përfundojë perioda e gabimeve dhe eksperiencave të hidhura në jetë. Me zgjerimin e njohjes dhe sekreteve të gjithësisë do të përforcohet shkenca e njohjes së Zotit dhe do të lindë një shoqëri e freskët dhe me plot dije, njohje dhe dritë hyjnore. Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Zoti i Madhërishëm me dritën e imam Mehdiut do të ndriçojë botën nga errësira. Pas kohës së dhunës e shtypjes, do të përhapet drejtësia dhe me largimin e injorancës, botën do ta mbulojë dija dhe përparimi."

Bertnard Rasel ka thënë: "Vërtet bota është në pritje të një shpëtimtari që do të bëjë unitetin e saj nën flamurin e përbashkët dhe nën parrullën e përbashkët".

Fizikanti i njohur **Albert Ajnshtajn** ka thënë: "S`ka dyshim se nuk është e largët ajo ditë në të cilën e gjithë bota do të hyjë në paqë dhe kthjelltësi. Në atë ditë njerëzit do të jenë të dashur dhe vëllezër me njëri tjetrin".

Dikush mund të pyesë: "***Si do t`ia arrijë imam Mehdiu të bëjë unitetin e kësaj bote nën hijen e një shteti të vetëm***"?

Kur`ani famëlartë në disa ajete të tij dëshmon se bota do të udhëhiqet nën hijen e një shteti të vetëm, me kulturë të përbashkët dhe me ngjyrat e përparimit të përbashkët që është Islami. E njëjta gjë thuhet edhe tek hadithet që flasin për udhëheqjen e botës nën flamurin e imam Mehdiut (paqja e Allahut qoftë mbi të!). Allahu i Madhëruar në suren Saf, ajeti 9 thotë:

هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ وَلَوْ كَرِهَ الْمُشْرِكُونَ (٩)

"Ai është i cili dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzim dhe vërtetësi që të dominojë feja e tij edhe pse e kundërshtojnë mushrikët (politeistët)".

Për t`iu përgjigjur pyetjes së lartpërmendur se si do të jetë e mundur që bota të udhëhiqet nga një shtet i vetëm në fillim duhet të përmendim disa tregues:

Së pari: Pas mbarimit të luftës së dytë botërore dijetarët përcillnin mendime që tërhiqnin vëmendjen e gjithë botës. Ata thoshin: 'Me qëllim që të mos biem në luginën e luftës së tretë duhet patjetër që të formohet një shtet i përbashkët me kulturë të përbashkët që të udhëheqë

gjithë botën. Dijetarët shtojnë se shkak i luftërave janë padrejtësia dhe padituria ndaj shumë gjërave.’

Gjithashtu ata kanë thënë: ‘Është e vërtetë se padrejtësia në të cilën është zhytur njerëzia deri tek qimet e kokës së tyre dhe padituria për shumë gjëra janë shkaktarët më të rrezikshëm për rendin, qetësinë, stabilitetin, unitetin...etj!. Prandaj, nuk gjendet rrugë tjetër shpëtimi prej hijes së luftës së tretë botërore me përjashtim të formimit të një shteti të vetëm që të udhëheqë mbarë botën.’

Së dyti: Dijetarët e sociologjisë dhe ato psikikës kanë konstatuar se: ‘Baza e vetme për ndërtimin e një shteti të përbashkët është pjekuria mendore dhe përsosmëria e mendimeve. Sa më shumë të shtohet pjekuria mendore tek njerëzit aq më tepër shtohet aftësia e pranimit për të jetuar nën udhëheqjen e një shteti të vetëm dhe me kulturë të përbashkët’.

Për sqarime më të shumta mund të lexoni me vëmendje literaturat e shkencës së sociologjisë dhe të psikikës.

Këtë çështje ata dijetarë sjellin e ilustrojnë me këtë shembull duke thënë se: ‘Në epokën e gurit njeriu nuk ka qenë në atë shkallë të pjekurisë mendore. Për këtë ai jetonte me ato mjete primitive që kishte. Më pas mendja e tij filloi të zhvillohet më shumë dhe filluan të dukeshin shenjat e pjekurisë në mendjen e tij. Ai formoi familje, më vonë mendja u zhvillua më shumë dhe njeriu filloi të jetojë nën udhëheqjen e një fisi. Sa më shumë shtohet pjekuria mendore, aq më shumë shtohet etja për të jetuar me të tjerët derisa u formua shteti që përbëhej nga miliona njerëz. Përsosmëria e njeriut filloi të rritej shkallë shkallë edhe më tej derisa u formua shteti me njëzet milionë njerëz, e më pas me njëqind million dhe arriti që shteti i vetëm të udhëheqë mbi gjashtëqind million njerëz siç është India. Më vonë numuri i njerëzve që udhëhiqeshin nga një shtet arriti në miliardë e një çerek milion siç është Kina në ditët e sotme.

Nëse është formuar shtet i cili udhëheq një miliard e një çerek milioni njerëz, a gjindet problem në formimin e një shteti që të udhëheqë katër miliard njerëz? Sigurisht që nuk gjendet as më i vogli problem për këtë gjë.

Karakteristikat e shtetit të imam Mehdiut

1- Plotësimi i dritës së Allahut dhe dominimi i Islamit mbi të gjitha fetë:

Kur’ani fisnik në suren Teube ajetet 32 dhe 33 thotë:

يُرِيدُونَ أَنْ يُطْفِئُوا نُورَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ وَيَأْبَى اللَّهُ إِلَّا أَنْ يُنِيرَ نُورَهُ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ (٣٢) هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَى وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظَاهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ وَلَوْ كَرِهَ الْمُشْرِكُونَ (٣٣)

“Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e Allahut me gojën e tyre, por Allahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mohuesit ta urrejnë këtë gjë.

(Allahu) Është Ai që e ka dërguar të Dërguarin e Tij me udhërrëfimin (Kuranin) dhe fenë e vërtetë, për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë, edhe sikur idhujtarët ta urrejnë këtë gjë.”

Në suren Saf ajetet 8 dhe 9, Allahu i Madhëruar thotë:

يُرِيدُونَ لِيُطْفِئُوا نُورَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ وَاللَّهُ مُتِمُّ نُورِهِ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ (٨) هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَىٰ
الدِّينِ كُلِّهِ وَلَوْ كَرِهَ الْمُشْرِكُونَ (٩)

Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojën e tyre, por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe pse (këtë gjë) e urrejnë jobesimtarët.

“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.”

Gjithashtu, në suren Fet’h, ajeti 28 Allhu i Madhëruar thotë:

هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَىٰ الدِّينِ كُلِّهِ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ شَهِيدًا (٢٨)

Dhe: Është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me Udhëzimin dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë. Allahu mjafton si dëshmitar!”

Komentues të shumtë të Kur’anit, si Kurtubiju në tefsijrin e tij, vëllimi 8, faqja 12, Fahri Raziu, në tefsijrin e tij, vëllimi 16, f. 40, e të tjerë kanë thënë qartë se ky premtim i Allahut do të realizohet në kohën e imam Mehdiut dhe në atë kohë Islami do të dominojë mbi të gjitha fetë, në lindje dhe në perëndim të rruzullit tokësor dhe do të formohet shteti mbarë botëror islam.

2- Punëmirët do të jenë trashëgimtarët dhe prijësit në tokë

Allahu i Madhëruar në Kur’an, sure El Enbija, ajeti 105 thotë:

وَلَقَدْ كَتَبْنَا فِي الزَّبُورِ مِنْ بَعْدِ الذِّكْرِ أَنَّ الْأَرْضَ يَرِثُهَا عِبَادِيَ الصَّالِحُونَ (١٠٥)

“Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të mirë.”

Po ashtu në suren Nur, ajeti 55 thotë: **“Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t’ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë...”**

3- Ndërtimi i një shoqërie të përbashkët dhe të pastër

Bazuar në ajetet e lartpërmendura sqarohet se prej karakteristikave të shtetit të Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) është se shoqëria e asaj kohe do të jetë e përbashkët dhe do të drejtohet nga duart e punëmirëve. Këta punëmirë i përmend edhe ajeti 41 i sures Haxh që thotë:

الَّذِينَ إِنْ مَكَّنَّاهُمْ فِي الْأَرْضِ أَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ وَأَمَرُوا بِالْمَعْرُوفِ وَنَهَوْا عَنِ الْمُنْكَرِ وَلِلَّهِ عَاقِبَةُ الْأُمُورِ (٤١)

“(Allahu i ndihmon edhe) ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zeqatën, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.”

4- Realizimi i qëllimit të krijimit të njeriut:

Allahu i Madhëruar në suren Dharijat, ajeti 56 thotë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ (٥٦)

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”

Ky ajet i bekuar tregon qartë qëllimin e krijimit të njeriut që është adhurimi i singertë i Allahut të Vetëm e të Pashoq. Ky qëllim do të realizohet plotësisht në kohën e qeverisjes së imam Mehdiut si në rang individual ashtu edhe atë shoqëror.

Të nderuar të pranishëm! Të jemi me imam Mehdiun do të thotë të jemi në thellësi të Islamit, pra të jemi me drejtësinë dhe ta praktikojmë atë me të gjitha format dhe mënyrat në jetën tonë të përditëshme. Të jemi të drejtë me Allahun, të drejtë me vetveten, të drejtë me familjen dhe me shoqërinë. Kur flasim për drejtësinë, kjo nuk ka kuptimin që të jemi të drejtë vetëm me myslimanët, por të jemi të drejtë me të gjithë njerëzit. Prandaj, që të jemi prej përkrahësve të imam Mehdiut nuk do të thotë që vetëm të përjetojmë dashurinë për atë, apo të lutemi për ardhjen e tij, ndërkohë që i bëjmë padrejtësi njëri-tjetrit, qoftë me fjalë apo me vepra.

Të dashur miq, këto pak fjalë modeste rreth shpëtimtarit të njerëzimit do t’i mbyll me një lutje të imam Sexhadit, i biri i imam Husejnit (paqja e Allahut qoftë mbi të dy!), dhe nipi profetit Muhamed (paqaj dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i cili ka thënë: “O Zot i Madh, ma zbukuro zemrën time dhe ma trego atë ndriçim të kësaj bote. Ma drejto shikimin në drejtim të tij. Shpejtoje ardhjen e tij dhe bëje të lehtë shfaqjen e tij. Zgjeroje rrugën dhe metodën e tij dhe mua më udhëzo në rrugën e tij. Urdhrin e tij bëje të zbatueshëm dhe përforcoje përkrahjen e tij. Me duart e tij ujiti tokat Tua dhe zgjoji robërit e Tu, që të zbatojnë urdhrat e tij, ngase korrupsioni dhe padrejtësia i ka mbushur shkretëtirat dhe detet. Atëherë o Zot, mikun Tënd dhe nipin e të dërguarit Tënd, shfaqe sa më shpejtë, me qëllim që drejtësia të vendoset në tokë ashtu siç duhet. O Zot, atë bëje që të mbrojtë të shtypurit dhe të ndihmojë personat që nuk presin ndihmë nga askush tjetër përveç Ty”.